# DËSHMI ARKIVI

**A-423712**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 37-vjeçarja shtatzënë ndërroi jetë gjatë transportimit në Tiranë, e motra mes lotësh: Na vonuan tre orë n ë Pogradec, mbase do kishte shpëtuar… – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/37-vjecarja-shtatzene-nderroi-jete-gjate-transportimit-ne-tirane-e-motra-mes-lotesh-na-vonuan-tre-ore-ne-pogradec-mbase-do-kishte-shpetuar/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 05:13:22 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 31 gusht 2026, 12:03:33 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7509c60aa6fa2f74de377710ad4fab3785101d00fdd5b5c6af32d8c93aaea9b1` |
| TEKSTI | `df9196a0ad98d26e26115909574639e02c847c5aa3bd0001462cdda40ce7c3d6` |
| PAMJA | `bdd85891dc237f78a368e2969608847305b6da22738619875c7c6a57a6293026` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c0fbb4e7296095cd6704cedaa9b8a2643703ee14861d5f4431c7f3ad246d5626` |
| E MËPARSHMJA | `6aa142aca4b75e7acc44a40c4eca05d0d9562f5ce0929afbad2c209e6794848b` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c0fbb4e7296095cd6704cedaa9b8a2643703ee14861d5f4431c7f3ad246d5626`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Motra e 37-vjeçares shtatzënë që humbi jetën gjatë transportit drejt Tiranës, kërkon zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe drejtësi. Ajo rrëfen se motra e saj, shtatzënë në muajin e shtatë, u paraqit në maternitetin e Pogradecit me dhimbje të forta rreth mesnatës dhe, sipas saj, pas një ekoje u konstatua gjakderdhje e brendshme dhe nevoja për transport urgjent drejt Tiranës.

***Motra e 37-vjeçares**: Vajta e çova në maternitet sepse motra ishte shtatzënë. Aty ishte mjekja roje dhe i bëri një eko, tha ka gjakderdhje të brendshme. Ajo tha duhet ta çojmë për Tiranë direkt. Pastaj u mblodhën të gjithë infermierët, dhe mjekja tha duhet çuar sa më parë. Dëgjova disa që po thoshin "duhet të vijë helikopteri", ndërsa disa thoshin "jo nuk vjen tani se është natë". Kështu i dëgjoja. Ajo tha 'nuk kam çfarë t'i bëj më'. Pastaj nuk e di me kë foli doktoresha, erdhën mjekët e reanimacionit të spitalit të Pogradecit. Ata thoshin nuk mund ta çojmë pa pasur një mjek me vete. Atje në reanimacion pati edhe disa vonesa të tjera.*

Sipas dëshmisë së saj, nga momenti i paraqitjes në spital deri në nisjen me ambulancë kanë kaluar rreth tre orë, kohë gjatë së cilës familjarët kanë kërkuar që 37-vjeçarja të transportohej sa më shpejt. Motra pretendon se në spital është diskutuar edhe mundësia e transportit me helikopter, ndërsa më pas është vendosur që pacientja të shoqërohej nga një mjek gjatë udhëtimit.

37-vjeçarja u nis drejt Tiranës rreth orës 04:00, por gjatë rrugës gjendja e saj u rëndua dhe ajo ndërroi jetë. Motra e saj ngre pikëpyetje mbi kohën e

5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

qëndrimit në Pogradec dhe kërkon që autoritetet të përcaktojnë nëse vonesat kanë ndikuar në fatin e pacientes.

***Motra e 37-vjeçares**: Me ambulancë për Tiranë e nisën në orën 4 të mëngjesit. Ajo ka qenë më dhimbje gjatë gjithë kohës. Nga ora 1 deri në 4 i vendosën vigonë, serume, nuk e di… unë po i thoja ta çojmë sa më shpejt se po e shikoja që kishte shumë dhimbje. U nisëm drejt Tiranës. Të paktën motra do kishte shpëtuar, mbase fëmija jo, s’e di. Sikur gjysmë ore më përpara të ishim nisur do kishim arritur në Tiranë më shpejt. Tre orë në Pogradec kanë qenë humbje kohe. Kërkoj drejtësi, të zbardhet e vërteta, iku nga pakujdesia apo nga shkaqe të tjera natyrore? Po të kishte pasur më shumë shpejtësi, motra do ishte këtu sot.*

Shkaqet e sakta të vdekjes pritet të përcaktohen nga ekspertiza dhe autopsia mjeko-ligjore.

#Pogradec #Shtatzënë #Zilia

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



VENDI

**Nis viti i ri shkollor, Skënder Hita mesaz...**

Xhuljana Zhuleku · 3 minuta më parë



VENDI

**Alarmi i rremë për bombë në shkollën...**

Xhuljana Zhuleku · 10 minuta më parë



EKONOMI

**Nafta “kapërcen” 230 lekë për litër,...**

Xhuljana Zhuleku · 38 minuta më parë




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.